



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks : 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



BULETINI DITOR I FSSHM-së

PËRMBLEDHJE INFORMACIONESH NGA LËMIA E SHËNDETËSISË TË MARRA NGA SHTYPI DITOR DHE MEDIUMET ELEKTRONIKE

06 - 08 Shkurt 2016



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks: 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



ZHURNAL [®]
Agjenci e Lajmeve

Klinika e Syve në Shkup në pranverë me tre shërbime të reja



Shkup, 6 shkurt - Pas një shkëputje 15 vitesh në këtë klinikë rikthen intervenimet e cross linkingut, keratoplastikës dhe gllaukomës.

Deri në fund të këtij muaji duhet të realizohet intervenimi i parë i cross linkingut, ose thënë ndryshe intervenim i korneas, ndërsa deri në fund të marsit duhet të fillojë edhe transplatimi i korneas dhe implatimi i implanteve për të normalizuar tensionin në sy.

“Ne kemi paraparë rreth 30 deri më 40 intervenime për sëmundjen e crosslinkingut të bëhen në vit. Si fillim janë të mjaftueshme dhe

besojmë që çdo vit do të jetë ajo sipas nevojave të pacienteve. Ne kemi qef të kemi sa më pak paciente të tilla. Mirëpo fatëkeqësisht ka pacient dhe ne do duhet ato pacient ti trajtojmë definitivisht të gjithë. Për ndërhyrjen e keratoplastikës ose transplatimi i kornes kemi paraparë në buxhetin tonë diku rreth 30 ose 35 intervenime. Ndërsa për gllaukomën janë paraparë rreth 20 intervenime këtë vit ndërsa vitet e tjera do të shohim”, shprehet drejtori i klinikës së Syve, Iljaz Ismaili.

Fondi për Sigurim Shëndetësor mbulon 90 për qind të shpenzimeve, ndërsa 10 përqind participim paguajnë pacientët për këto intervenime.

E mira është se në rast se rritet numri i pacientëve të cilët kanë nevojë për këto shërbime, FSSHM qëndron e hapur për të zgjeruar listën e numrit të intervenimeve deri në fund të vitit, sqaron Ismaili.

“Një procedur e crosslinkingut që është futur në çmimoren e fondit është diku rreth 20 mijë denarë, por kjo për pacientet do të jetë vetëm me participim, me librez shëndetësore dhe me kontrolle normale të pacienteve. Sa i për ketë për Keratoplastikës e cila ka çmim mbi 210 mijë denarë në institucionet private, te klinika jonë do të kushtojë me participim adekuat që është caktuar nga FSSHM-së. Ndërsa trajtimi i gllaukomës me implante është mbi 77 mijë denarë nga shkakut se çmimi i implanteve është shumë i lartë, kurse tash kjo do të jetë e mbuluar nga sigurimi shëndetësor i Maqedonisë dhe do të paguhet vetëm participim”, shprehet drejtori i klinikës së Syve, Iljaz Ismaili.

Shuma e përgjithshme e investimeve në pajisje dhe materijale është rreth 10 milion denarë, ndërsa ekipi mjekësor që do të kryej intervenime është trajnuar në Bullgari.



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks: 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



Gratë shqiptare të kenë kujdes të madh te gjinekologët amë nga Tetova dhe Shkupi që mos të mashtrohen

Shkup, 5 shkurt -Vajzat dhe gratë shqiptare në Maqedoni për shkak se nuk kanë informacione të nevojshme ata keqpërdoren nga gjinekologët amë të cilët punojn me Fondin për Shëndetësi.

Gratë që kanë sigurim shëndetësor në mënyrë të paligjshme paguajnë para gjatë kontrolleve te gjinekologët amë në Maqedoni. Këtë hallë të madh e ka edhe Mimoza nga Shkupi, e cila u paraqit në redaksinë tonë të lajmeve "Zhurnal".

Ajo tregon storie tronditëse se si gjatë çdo vizite te gjinekologu amë paguan nga 200-500 denarë, pa i dhënë sqarime gjinekologu se çfarë shërbime paguan pacientja." Unë jam e martuar katër vite. Nuk kam fëmijë. Shumë shpesh shkoj te gjinekologja ime. Ajo gjatë çdo kontrolli më merr nga 200-500 denar. Nuk di atëherë pse unë kam sigurim shëndetësor kur paguaj para", shprehet Mimoza .

Ajo nuk e përmend ordinancën gjinekologjike që i merr ato para në mënyr të jashtëligjshme, për shkak të frikës se mos ketë ndonjë pasojë. Por Mimoza na rrëfen se të gjithë gratë që ajo njeft kanë këtë hallë të madh me pagesën. Sipas saj në Shkup ka shumë gjinekologë te të cilët edhe pse je paciente e regjistruar te një gjinekologë, nuk mund të kalosh assesi pa paguar shërbimin ilegal.

Ndryshe, informacionet tona jozyrtare flasin se rregullat e Fondit për Shëndetësi janë ndryshe. Një grua që ka sigurim shëndetësor(librezë) dhe është e regjistruar te ndonjë gjinekologë amë, ajo asnjëherë nuk guxon të jep as 1 denar për kontrollet.

Fondi i ka obliguar gjinekologët amë që kontrollet gjinekologjike, eho-ja e barkut, kolposkopia, marrja e brisqeve mikrobiologjike dhe PAP-të një herë në vit të jenë FALAS.

Megjithatë gjinekologët e papërgjegjshëm që në mënyrë jolegale paguajnë shërbime duhet të paraqiten urgjentisht nga pacientet te kontrolle e Fondit të Shëndetësisë në numrin falas 0800 33 222 dhe numrin mobil 076 339-180 po ashtu rastin duhet ta paraqesin edhe në Drejtorinë për të Hyra Publike 198 .

Pasi gjinekologët amë marrin para pa mos dhënë llogari fiskale. Ndryshe, gjinekologët amë në Maqedoni marrin kapitacionin mujor(rrogë) nga Fondi i Shëndetësisë varësisht nga numri i pacienteve.

Ka shumë gjinekologë që kanë edhe nga 5000 paciente të cilët marrin nga Fondi për një muaj 4000 euro. Edhe pse gjinekologët mbeten mjekët më të paguar, ata rrjepin ilegalisht gratë hallexhinjve shqiptare që mezi mbijetojnë në këtë kohë krize.

Informacionet e Agjencisë së Lajmeve Zhurnal flasin se përveç Shkupit, gjinekologët nga Tetova që janë koncesioner në Spitalin e Tetovës si gjinekolog amë bëjnë këtë keqpërdorim të pacientëve duke fituar çdo ditë nga 200 euro para ilegale.

Rastet e këtilla duhet urgjentisht të denoncohen në Fond dhe Drejtorin e të ardhurave publike, pasi me këtë mjekët do të dënohen pasi plaçkitin grat shqiptare.



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks: 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



Mjekët: Maqedonia nuk është vend në rrezik



Edhe pse bota është vënë në alarm, në Maqedoni nuk ka rrezik për përhapjen e virusit Zika thonë epidemiologët.. Edhe pse bota është vënë në alarm, në Maqedoni nuk ka rrezik për përhapjen e virusit Zika thonë epidemiologët duke sqaruar se në këtë periudhë kohore në vend nuk ka mushkonja që janë bartëset kryesore të këtij virusi.

Ai mund të vjen vetëm përmes ndonjë personi të infektuar që ka udhëtuar në rajonet tropikale. Gjithsesi shpallja e rrezikut global, ka bërë që edhe institute I shëndetit public ta marrë me seriozitet sëmundjen e re që është krahasuar me Ebolën.

Edhe pse besohet se ai përcillet vetëm përmes mushkonjave, në SHBA këtë javë u zbuluar një rast ku virusi ishte përcjellë përmes mardhënieve intime.

Simptomat e tij janë kokëdhembje , ethe, pucrra dhe dhimbje të kyceve. Sipas mjekes Largime Jusufi Ballazhi, rreziku më i madh i përhapjes së virusit Zika është pickimi.

"Mundësia e vetme dhe e sigurt deri tani është pickimi, ndërsa mendohet që mundet edhe përmes dmth rrugës transplacentare nga nëna tek foshnja, rruga tjetër është me transfuzion të gjakut, dmth personi që është donatori ti ketë dhënë recipientit, marësit të gjakut, gjaku që ka Brenda virusin Zika, rruga tjetër është edhe me akt seksual që mundet të përcillet..janë këto qe organizta botërore e shëndetësise nuk ka dalë me një deklaratë qe kjo është sigurt 100% që mund ta shkaktojë këtë virus", shprehet mjekja Largime Jusufi Ballazhi.

Edhe pse përhapja e virusit Zika po ec me hapa të shpejtë, megjithatë sa i përret vendit tonë, nuk ka vend për panik.

"Në vendin tonë nuk kemi asnjë të raportuar me këtë infektim. Nuk ka vend për panik. Po vijmë në sezonin e mushkonjave, kështu qe gratë shtatëzëna, është mirë që të mos bëjnë panik që cdo mushkonjë që nuk do të jetë e llojit të mushkonjës së tigris (aedes), do ta pickojë dhe do të bëj panik sepse mund të ngrej pak temperaturë", shprehet mjekja Largime Jusufi Ballazhi.

"Përvoja e derita nishme tregon se virusi Zika në formën e lehtë, kalon për 4 deri më 7 ditë . Nuk lë pasoja më të rënda dhe nuk është vërejtur ndonjë formë e rëndë e kësaj sëmundjeje deri tani", shprehet mjekja Gordana Kuzmanovska nga instituti për shëndet publik.



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks: 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



Virusi ka mbërritur tashmë edhe në Evropë. Ka të sëmurë në Itali, Britani dhe Spanjë, por të gjithë ata ishin kthyer nga udhëtimet në Amerikën Jugore dhe Karaibet.

Klinika e Syve në Shkup në pranverë me tre shërbime të reja



Klinika e Syve në Shkup këtë pranverë fillon me tre shërbime të reja oftamotologjike...

Pas një shkëputje 15 vitesh në këtë klinikë rikthen intervenimet e cross linkingut, keratoplastikës dhe gllaukomës.

Deri në fund të këtij muaji duhet të realizohet intervenimi i parë i cross linkingut, ose thënë ndryshe intervenim i korneas, ndërsa deri në fund të marsit duhet të fillojë edhe transplatimi i korneas dhe implatimi i implanteve për të normalizuar tensionin në sy.

“Ne kemi paraparë rreth 30 deri më 40 intervenime për sëmundjen e crosslinkingut të bëhen në vit. Si fillim janë të mjaftueshme dhe besojmë që çdo vit do të jetë ajo sipas nevojave të pacienteve. Ne kemi qef të kemi sa më pak paciente të tilla. Mirëpo fatëkeqësisht ka pacient dhe ne do duhet ato pacient ti trajtojmë definitivisht të gjithë. Për ndërhyrjen e keratoplastikës ose transplatimi i kornes kemi paraparë në buxhetin tonë diku rreth 30 ose 35 intervenime. Ndërsa për gllaukomën janë paraparë rreth 20 intervenime këtë vit ndërsa vitet e tjera do të shohim”, shprehet drejtori i klinikës së Syve, Iljaz Ismaili.

Fondi për Sigurim Shëndetësor mbulon 90 për qind të shpenzimeve, ndërsa 10 përqind participim paguajnë pacientët për këto intervenime.

E mira është se në rast se rritet numri i pacientëve të cilët kanë nevojë për këto shërbime, FSSHM qëndron e hapur për të zgjeruar listën e numrit të intervenimeve deri në fund të vitit, sqaron Ismaili.

“Një procedur e crosslinkingut që është futur në çmimoren e fondit është diku rreth 20 mijë denarë, por kjo për pacientet do të jetë vetëm me participim, me librez shëndetësore dhe me kontrolle normale të pacienteve. Sa i për ketë për Keratoplastikës e cila ka çmim mbi 210 mijë denarë në institucionet private, te klinika jonë do të kushtojë me participim adekuat që është caktuar nga FSSHM-së. Ndërsa trajtimi i gllaukomës me implante është mbi 77 mijë denarë nga shkak se çmimi i implanteve është shumë i lartë, kurse tash kjo do të jetë e mbuluar nga sigurimi shëndetësor i Maqedonisë dhe do të paguhet vetëm participim”, shprehet drejtori i klinikës së Syve, Iljaz Ismaili.



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks : 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



Shuma e përgjithshme e investimeve në pajisje dhe materijale është rreth 10 milion denarë, ndërsa ekipi mjekësor që do të kryej intervenime është trajnuar në Bullgari.



Maqedonia nuk është vend në rrezik



Edhe pse bota është vënë në alarm, në Maqedoni nuk ka rrezik për përhapjen e virusit Zika thonë epidemiologët duke sqaruar se në këtë periudhë kohore në vend nuk ka mushkonja që janë bartëset kryesore të këtij virusi.

Ai mund të vjen vetëm përmes ndonjë personi të infektuar që ka udhëtuar në rajonet tropikale. Gjithsesi shpallja e rrezikut global, ka bërë që edhe institute I shëndetit public ta marrë me seriozitet sëmundjen e re që është krahasuar me

Ebolën.

Edhe pse besohet se ai përcillet vetëm përmes mushkonjave, në SHBA këtë javë u zbuluar një rast ku virusi ishte përcjellë përmes marrëdhënieve intime.

Simptomat e tij janë kokëdhembje, ethe, pucrra dhe dhimbje të kyceve. Sipas mjekes Largime Jusufi Ballazhi, rreziku më i madh i përhapjes së virusit Zika është pickimi.

“Mundesia e vetme dhe e sigurt deri tani është pickimi, ndërsa mendohet që mundet edhe përmes dmth rrugës transplacentare nga nëna tek foshnja, rruga tjetër është me transfusion të gjakut, dmth personi që është donatori ti këtë dhënë recipientit, marrësit të gjakut, gjaku që ka Brenda virusin Zika, rruga tjetër është edhe me akt seksual që mundet të përcillet...janë këto që organizta botërore e shëndetësive nuk ka dalë me një deklaratë që kjo është sigurt 100% që mund ta shkaktojë këtë virus”, shprehet mjekja Largime Jusufi Ballazhi.

Edhe pse përhapja e virusit Zika po ec me hapa të shpejtë, megjithatë sa i përret vendit tonë, nuk ka vend për panik.



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks: 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



“Në vendin tonë nuk kemi asnjë të raportuar me këtë infektim. Nuk ka vend për panik. Po vijmë në sezonin e mushkonjave, kështu që gratë shtatëzëna, është mirë që të mos bëjnë panik që cdo mushkonjë që nuk do të jetë e llojit të mushkonjës së tigrin (aedes), do ta pickojë dhe do të bëjë panik sepse mund të ngrej pak temperaturë”, shprehet mjekja Largime Jusufi Ballazhi.

“Përvoja e derita nishme tregon se virusi Zika në formën e lehtë, kalon për 4 deri më 7 ditë . Nuk lë pasojë më të rënda dhe nuk është vërejtur ndonjë formë e rëndë e kësaj sëmundjeje deri tani”, shprehet mjekja Gordana Kuzmanovska nga instituti për shëndet publik.

Virusi ka mbërritur tashmë edhe në Evropë. Ka të sëmurë në Itali, Britani dhe Spanjë, por të gjithë ata ishin kthyer nga udhëtimet në Amerikën Jugore dhe Karaibet.



Qendra për transplantim fitoi mbështetje nga deputetët



Zëvendësministri i Shëndetësisë, Jovica Andovska në elaborimin tha se qëllimi i këtij Propozim – ligji është krijimi i kushteve për kryerjen e transplantimit dhe intervenimeve të ndërlikuara kirurgjike në Qendrën për përsosmëri, si dhe themelimin e Klinikës universitare për mjekësi transplative dhe sëmundje kirurgjike. Për themelimin e tij parashihen rreth 64 milionë denarë.

Ai theksoi se do të jenë të nevojshme ndryshime në strukturën organizative, edukimin e kuadrit dhe rritjen e vetëdijes publike për dhurimin e organeve.

Në Maqedoni, siç tha, transplantimi është edhe një degë mjaft e zhvilluar e mjekësisë.

-Edhe krahas asaj që transplantimi i veshkave në Republikën e Maqedonisë ekziston në vazhdimësi në 25 vitet e fundit, si transplantim i vetëm i organeve, ajo megjithatë në vëllimin aktual nuk i kënaq nevojat dhe është nën standardet evropiane, tha Andovski.



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks : 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



Shtoi se mungon transplantimi i organeve të tjera, si mëlçia e zezë, pankreasi, zemra dhe mushkëritë të cilat tashmë janë procedura rutinore në shumë shtete evropiane.

-Themelimi i qendrës nacionale për transplantimin e organeve dhe indeve dhe sëmundjeve kirurgjike me kuadër me përvojë dhe të dëshmuar në vend do të thotë edhe rritje e transplantimit të veshkës, jo vetëm si numër por edhe si cilësi shtesë në këtë praktikë të keqe mjekësore, tha Andovski.

Andon Çibishev i VMRO-DPMNE-së vlerëson se bëhet fjalë për ligj shumë të rëndësishëm dhe avangard, i cili i nevojitet Republikës së Maqedonisë. Duke u përqendruar në transplantimin në shtetin tonë, përkujtoi se ai daton që nga vitet e 80-ta.

Biljana Nasteska e LSDM-së u pajtua se ligji është avangard dhe shtoi se transplantimi është veprimtari fisnike dhe komplekse. E përshëndeti idenë për një ligj të tillë dhe Qendër në shtetin dhe rajonin tonë. Ajo dha vërejtje lidhur me buxhetin, organizimin dhe udhëheqjen e kësaj Qendre.